



Moment nga informimi publik mbajtur me datën 6 dhjetor 2018 në Qirez, Komuna Skenderaj

Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 4 Komuna, 15 Zona Kadastrale

Analizat e hollësishme të të dhënave kadastrale në dispozicion, në formën analoge dhe digjitale, të disa zonave kadastrale kanë treguar se këto të dhëna nuk pasqyrojnë gjendjen reale të terrenit. Prandaj Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe organet komunale përveç mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit, ndërmarrin edhe veprime plotësuese përmes rindërtimit të informacioneve kadastrale me qëllim të:

1. kompletimit të të dhënave mbi pronësinë për pronën e paluajtshme sipas gjendjes reale në terren;

2. rindërtimit të të dhënave për pronën e paluajtshme;

Ndërsa disa prej kriterëve për përzgjedhjen e zonave kadastrale për rindërtim janë shkalla e mospërputhshmërisë ndërmjet të dhënave tekstuale dhe grafike, numri i madh i kërkesave për regjistrimin e transaksioneve, kapaciteti teknik i Zyrave Kadastrale Komunale të përfshira dhe buxhetin në dispozicion.

Duke e ditur se rindërtimi i informacioneve kadastrale është një mundësi e mirë për qytetarët që të rregullojnë të drejtat e tyre mbi pronën e paluajtshme, pa nevojë që t'i nënshtrohen ndjekjes së procedurave administrative nëpër zyrat kadastrale komunale dhe gjykata, si dhe duke e ditur se regjistrimi i pronës përmes projektit bëhet pa pagesë, e rëndësishme është pjesëmarrja aktive e qytetarëve në këtë proces. Sa i përket implementuesit të projektit, qytetarët do të mund të kontribuojnë në projekt gjatë të gjitha

fazave të implementimit të tij.

Fillimisht do të mundësohet përmes takimit informues që i paraprindë punëve në terren, pastaj edhe gjatë fazës së punëve në terren, përmes diskutimit me pronarët, si dhe gjatë fazës së shikimit publik ku do të shfaqen të gjitha rezultatet e projektit. Në fazën e shikimit publik e cila zgjatë 60 ditë, do të prezantohet gjendja e fundit e pronave, dhe qytetarët do të mundën të kontestojnë apo aprovojnë të drejtat mbi pronat e tyre.

Bazuar në përvojën nga e kaluara, pjesëmarrja aktive e qytetarëve po del të jetë edhe pjesa më sfiduese e projektit. Projekti favorizon biseda me grupe pronarësh fqinjë e jo veç e veç me pronarë. Kjo për shkak se kështu do të zgjidheshin problemet ndërfqinjësore dhe sidomos do të mund të rregulloheshin kufijtë – të cilët kanë numër të madh e të panevojshëm të pikave kufitare.

Nëse është e nevojshme në këto biseda do të mund të thirren edhe Anëtarë të Komisionit për Rindërtim të Informacioneve Kadastrale, në të cilin Komision ka edhe përfaqësues të Komunës edhe përfaqësues nga Zona Kadastrale ku është duke u kryer rindërtimi.

E rëndësishme për të ditur është se Kompania gjeodezike e cila do të implementojë projektin, gjatë punës në terren do të kërkojë nga pronarët që t'i parashtrijnë dokumentet të cilat janë me interes për dëshmimin e pronësisë apo të kufijve. Dokumentet mund të jenë fotokopje, digjitale, ose të skanuara dhe duhet t'i dërgohen Komisionit.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim të pronës

Vendimin e noterit;
Vendimin e plotfuqishëm të gjykatës;
Vendimin e organit të administratës shtetërore;
Kontratën për transferimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, e vërtetuar nga organi kompetent;
Vendimin ose kontratën për privatizim të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit;
Vendimin e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit;
Vendimit të Komisionit për Rregullimin e Tokës;
Ndonjë dokument tjetër në të cilin me Ligje të veçanta është parashikuar regjistrimi i të drejtave pronësore.



RINDËRTIMI
I
INFORMACIONEVE
KADASTRALE
NË
BERIVOJCË
REGJISTRO
PRONËN
NË EMRIN TËND

Shembull poster, Zona Kadastrale Berivojcë

Rindërtimi, pjesëmarrja e qytetarëve dhe përfitimet

Fazat e realizimit të projektit

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka implementuar projektin për rindërtimin e informacioneve kadastrale në dhjetëra Zona Kadastrale në territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket suksesit të implementimit të tij, rezultatet janë të ndryshme, diku sukcesi ka qenë më i dukshëm e diku më i zbehtë. Ajo që është e rëndësishme për tu potencuar është se projekti ka shënuar sukses aty ku pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë më e theksuar, ndërsa rol të madh edhe në pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në projekt luan edhe informimi korrekt i tyre reth asaj se çka janë përfitimet konkrete, çka përfshihet në projekt e çka jo. Për këtë arsye, takimi i njoftimit publik mbahet me qytetarët mbahet me qëllim që pronarët të informohen për fillimin e rindërtimit të zonës kadastrale. Takimi për informimin publik bëhet kur qeveria deklaron se një zonë kadastrale do të rindërtohet dhe pikërisht para se të fillojë puna në terren. Në këtë takim me qytetarët marrin pjesë anëtarët e komisionit të rindërtimit nga AKK-ja, përfaqësues të nivelit qendror nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përfaqësues nga niveli lokal, respektivisht nga Komuna, si dhe përfaqësues nga kompania gjeodezike e zgjedhur për punë në terren. Në takim, me shumicë votash do të zgjidhet edhe një përfaqësues në Komision i cili vjen nga zona kadastrale subjekt i rindërtimit.

Çka përfshihet në Rindërtim dhe çka bëhet pa pagesë

Sa i përket shërbimeve që kryhen pa pagesë, e që në të kundërtën bartin kosto për vetë ata qytetarë që regjistrojnë pronën në mënyrë të rregullt në Zyrat Kadastrale Komunale, ato janë si vijon:

Bartja e pronësisë përmes Komisionit;

Ekzekutimi i Dokumenteve juridike që posedojnë banorët;

Krijimi i parcelave të reja sipas gjendjes faktike në terren;

Matja e shtëpive dhe objekteve tjera përcjellëse;

Informimi Publik -

Është faza e parë e projektit, ku njoftohen të gjithë banorët e zonës kadastrale (fshatit) për fillimin e projektit, përfitimet dhe obligimet e tyre.

Fushata e matjeve -

Në këtë fazë bëhen matjet e parcelave sipas gjendjes faktike në terren në praninë e pronarëve në të gjithë zonën kadastrale si dhe përgatiten lëndët për nënshkrim nga palët për të realizuar të drejtat e tyre pronësore. Në fshatin ku është duke u bërë fushata e matjes hapet zyra ku qytetarët mund të marrin informata më të hollësishme lidhur me pronat e tyre dhe me procedurat që duhet ti bëjmë për realizimin e drejtës së tyre.

Shikimi Publik-

Në këtë fazë bëhet prezantimi i të gjitha të dhënave të realizuara gjatë fushatës së matjeve të parcelave dhe objekteve në zonën kadastrale si dhe kontrollohen nga banorët se a është e nevojshme të bëhet ndonjë korrigjim i atyre të dhënave.

Futja e të dhënave në sistemin zyrtar të kadastrit-

Kjo është faza e fundit e realizimit të projektit, pas së cilës Komisioni bën aprovimin e projektit dhe banorët mund të pajisen me Certifikatë të pronës dhe Kopje plani pa pagesë në zyrën kadastrale komunale

Në cilat Komuna dhe Zona kadastrale do të kryhet rindërtimi

Republika e Kosovës ka gjithësej 38 Komuna dhe 1305 Zona Kadastrale. Deri më sot rindërtimit i janë nënshtruar 159 Zona Kadastrale, shumica me përkrahje financiare nga Banka Botërore, ndërsa së fundmi Agjencia Kadastrale e Kosovës është duke implementuar projektin për rindërtimin e informacioneve kadastrale në 15 Zona Kadastrale në katër Komuna; Viti, Kamenicë, Drenas dhe Skenderaj (shiko tabelën djathtas).

Është e rëndësishme të ceket se shumë nga proceset për të cilat qytetarët duhet të paguajnë kosto të ndryshme, varësisht prej shërbimit, në kuadër të projektit do të bëhen [pa pagesë](#).

Sllatinë - Viti
Zhiti - Viti
Pozheran - Viti
Sadovina e Jerlive - Viti
Hodonovc - Kamenicë
Rogoqicë - Kamenicë
Muqivercë - Kamenicë
Koperrnicë - Kamenicë
Berivojcë - Kamenicë
Çirez - Skenderaj
Baks - Skenderaj
Dashevc - Skenderaj
Kosterc - Skenderaj
Arlat - Drenas
Shtuticë - Drenas



Moment nga diskutimi me banorë dhe shikimi publik gjatë rindërtimit të informacioneve kadastrale



Kryetari Komunës Skenderaj z. Bekim Jashari, Deputetja e Kuvendit të Republikës së Kosovës z-nja Ganimete Musliu djh Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti prezantojnë projektin në Qirez, Komuna Skenderaj.

Shikimi publik, garanci dhe siguri

Për të siguruar se secili ndryshim i pronave do të bëhet me pajtimin e vetë banorëve të zonës kadastrale në rindërtim, pas përfundimit të punës në terren do të fillojë faza e shikimit publik, e cila do të zgjasë 60 ditë.

Gjatë kësaj kohe, pronarët do të kenë mundësinë t'i pranojnë apo kontestojnë rezultatet e projektit dhe informatat në regjistrin (RDPP), gjithmonë bazuar në dëshmi të pranueshme.

Rezultati mbi pronën konsiderohet si i aprovuar vetëm në rast se prona në fjalë nuk kontestohet, rrjedhimisht informata konsiderohet si e aprovuar dhe do të jetë ligjrisht e vlefshme, vetëm nëse pranohet nga pronari.

Shikimi publik do të kryhet në ndërtesat që ndodhen brenda zonës kadastrale, si dhe zyra/dhoma e shikimit publik do të jetë e hapur 4 orë në ditë.

Në vendet urbane dhe gjysmë-urbane orari i punës preferohet të jetë vonë pasdite apo në mbrëmje, pasi banorët në këto vende zakonisht punojnë larg nga shtëpitë e tyre gjatë ditës.

Në zyrën/dhomën do të punojë kuadri i cili është në gjendje të shpjegojë se si lexohen hartat, listat, të japë këshilla dhe të pranojë ankesat e banorëve.

Komisioni do të luajë rol aktiv dhe do të përpiqet t'i kontaktojë pronarët kur informatat janë të pamjaftueshme apo të dyshimta. Po ashtu Komisioni do të shqyrtojë ankesat, dhe do të ftojë palët për dëgjime dhe konsultime në lëndët e komplikuar.

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS DHE KOMUNA INKURAJONË BANORËT E ZONAVE KADASTRALE NË RINDËRTIM QË TË MARRIN PJESË AKTIVE NË FAZËN E SHIKIMIT PUBLIK QË TË KENË SA MË TË QARTË STATUSIN E PRONËS SË TYRE.

Kontakte të rëndësishme

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS
akk@rks-gov.net
038 512 353

ZYRAT KADASTRALE KOMUNALE

DRENAS
mialim.hajdari@rks-gov.net
045-191-223

SKENDERAJ
Sandra.Fazliu@rks-gov.net
038 200 42 708

KAMENICE
arta.r.gashi@rks-gov.net
038 200 47 609

VITI
tajar.neziri@rks-gov.net
0280 381 534

OPERATORI EKONOMIK
urbanmetropol.ofis@gmail.com
+377 44 77 44 77

E RËNDËSIHME PËR TU DITUR !

Informacione për qytetarët që janë pjesë e Projektit Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale Në rast se pronari është gjallë, është i nevojshëm vetëm letërnjoftimi dhe prania e të dy palëve (pronari edhe shfrytëzuesi) në zyrë për të nënshkruar procesverbalin.

Në rastet kur pronari nuk është gjallë, trashëgim marrësi duhet të kryej trashëgimin në Gjykata ose te Noteri dhe pastaj ta dorëzojnë Aktin e trashëgimisë në zyrën e projektit që do hapet në fshatin tuaj.

Në rast se pas ndarjes së parcelës ka ndryshim pronësie jashtë listës së trashëgimtarëve, duhet të jenë të pranishëm trashëgimtari me Akt trashëgimie dhe pala tjetër (shfrytëzuesi) për të nënshkruar procesverbalin.

Nëse palët kanë dokument juridik (kontratë të vërtetuar në Gjykatë, Aktvendim, Aktgjykim) duhet vetëm të i dorëzojnë në zyrë si kopje e vërtetuar nga origjinali te noteri (vërejtje: nuk bënë të dorëzohen origjinalet e dokumenteve). Nëse palët nuk kanë mundësi të kryejnë trashëgimin, me kërkesë të shfrytëzuesit mund të zyrtarizojnë ndarjet nga gjendja faktike por pronar mbetet i vjetri (sipas regjistrin kadastral).

GJATË PROCESIT NUK ËSHTË PARAPARË RREGULLIMI I TRASHËGIMISË NGA ANA E IMPLEMENTUESIT TË PROJEKTI.



Komuna Shtime, regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve

E DREJTA E GRUAS NË PRONË

TË QENIT PRONAR I PRONËS DO TË THOTË QË JU MUND TË ZOTËRONI, TË PËRDORNI DHE TRANSFERONI PRONËN BRENDA KUFIJVE TË PËRCAKTUAR ME LIGJ DHE NË PËRPUTHJE ME NATYRËN DHE QËLLIMIN E OBJEKTIT DHE INTERESIT PUBLIK. NDËRSA E DREJTA PËR TË PASUR PRONË ËSHTË E BARABARTË, SI PËR BURRAT ASHTU EDHE PËR GRATË

Në teori, nuk ekzistojnë pengesa ligjore që i ndalojnë gratë që të përdorin shërbimet e administrimit të tokës. Megjithatë, ndodh që disa norma kulturore të gëzojnë fuqi mbi ligjet, dhe ky pjesërisht është realiteti në zonat rurale, në fshatra dhe në qytete më të vogla.

Ndaj shpesh përballemi me situata ku gratë gëzojnë më pak qasje ndaj tokës apo zotërojnë thjesht të drejta joformale, apo se gratë humbasin të drejtat e pronësisë që u takojnë, si rezultat i favorizimit të afërmeve të tyre të gjinisë mashkullore.

Agjencia Kadastrale e Kosovës i kushton rëndësi të madhe barazisë gjinore në të drejta pronësore, duke lehtësuar qasjen e gruas në pronë, gjithnjë

duke u thirrur në legjislacionin në fuqi.

Komunikimi dhe ngritja e vetëdijes janë thelbësore në ndryshimin e vlerave dhe qëndrimeve, përfshirë edhe ato për barazinë gjinore dhe zotërimin e qeverisjes së tokës.

Komunikimi mund t'i mobilizoj njerëzit që të ndërmarrin veprime, siç është paraqitja e të drejtave të tyre mbi tokën, duke ndihmuar në ndërtimin e konsensusit mbi problemet dhe zgjidhjes së tyre të mundshme nëpërmjet pjesëmarrjes së të gjithë akterëve.

Avokimi i bazuar në dëshmi vërteton vlerën e procesit të barazisë gjinore, e cila me kontributin

dhe pjesëmarrjen e të gjithë akterëve, si femra dhe meshkuj, e bën të mundshme arritjen e një konsensusi dhe mbështetjen ndaj politikave që dalin nga kjo.

Sensibilizimi gjinor mund të duhet të integrohet në komunikim, ngritje të vetëdijes, përpjekje për avokim sepse disa qëndrime që ekzistojnë rreth barazisë gjinore dhe tokës mund të jetë e vështirë të ndryshohen.

Sensibilizimi i gjinor i efektshëm duhet të synoj si femrat dhe meshkujt e të gjitha moshave, feve, etnive, statusit shoqëror, etj.

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS DHE KOMUNA INKURAJONË GRATË BANORE TË ZONAVE KU ËSHTË DUKE U KRYER RINDËRTIMI QË TË BËHEN PJESËMARRËSE AKTIVE NË PROJEKT DHE TË REGJISTROJNË TË DREJTAT E TYRE TË BARABARTA NË PRONË.

A janë gratë edhe burrat të barabartë në të drejta pronësore

PO! Ligjet e Kosovës garantojnë barazinë dhe jo-diskriminimin. E drejta për të qenë pronar i pronës i përket të dyve burrave dhe grave pa dallim. Kushtetuta e Kosovës, ndër të tjera, garanton:

- barazinë para ligjit;
- të drejtën për të poseduar pronë;
- të drejtën për mjete juridike, për të kërkuar
- mbrojtje ligjore për të drejtat tuaja; dhe
- mbrojtjen kundër diskriminimit.

Ligjet e Kosovës garantojnë barazi midis grave dhe burrave në gëzimin e këtyre të drejtave.



Fushatë për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve

